

Nr.0201-399/9

07.02.2024

Shkup

PROCESVERBAL

**nga vazhdimi i parë i seancës së 4-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuele
mbajtur më 29.01.2024**

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë ishte i pranishëm dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të pranishëm nga Shërbimi Profesional: mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, Maja Damevska, dr.Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë: Ilija Xhingoski aorizues i SHTR Radio HIT FM SHPKNJP Shkup.

Z. Petrushevski hapi vazhdimin e parë të seancës së 4-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në ora 15:30 dhe u mbajt në ambientet e Agjencisë, salla e konferencave, kati i dytë.

Z. Petrushevski shpjegoi se do të vendoset për një pikë që është shtyrë në seancën e 4-të me titull " Propozim – vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR Radio HIT FM SHPKNJP Shkup". Mirëpo, duke qenë se në ndërkohë transmetuesi ka dorëzuar dokumentet e nevojshme që janë në pajtim me ligjin, ai propozoi që formulimi i titullit të ndryshohet dhe të lexohet "Propozim për ndërprerjen e procedurës së inicuar për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR Radio HIT FM SHPKNJP Shkup".

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 6 vota "pro", miratoi propozimin.

Udhëheqësja e Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit mr. Magdalena Davidovska Dovleva, shpjegoi Propozimin për ndërprerjen e procedurës së inicuar për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR Radio HIT FM SHPKNJP Shkup. Ajo ka shpjeguar se më 26.01.2024, transmetuesi ka dorëzuar në arkivin e Agjencisë dokumente nga Agjencia e Punësimit, nga ku konstatohet se janë lajmëruar për punësim 4 persona me orar të plotë pune, duke plotësuar kështu kushtet minimale kadrovike. Ai tha se sipas formularëve të dorëzuar M1, data e aplikimit për punësim është 29 janar dhe po ashtu nga dokumentet e dorëzuara shihet se personat e punësuar janë të lajmëruar për periudhë të caktuar prej 1 muji. Ndaj, ai tha se për një muaj do të duhet të bëhet sërish mbikëqyrje e jashtëzakonshme, por në këtë moment janë plotësuar kushtet minimale kadrovike.

Z. Petrushevski tha se ky është një hap i vogël pozitiv që mediat të mos e humbasin lejen. Ai deklaroi se do ta mbështesë propozimin.

Z.Fidasoski në pajtim me diskutimin konstatoi se në këtë moment SHTR Radio HIT FM SHPKNJP Shkup i plotëson kushtet minimale kadrovike deri më 29 shkurt dhe më 1 mars duhet të kryhet sërish mbikëqyrje nëse ka vazhdimësi në përmbushjen e obligimeve ligjore.

Këshilli i Agjencisë njëzëri ka miratuar Vendim për ndërprerjen e procedurës së inicuar për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR Radio HIT FM SHPKNJP Shkup, PA1 nr. 08-78 datë 07.09.2023.

Në pajtim me Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të jashtëzakonshme administrative nr.0305-498/1 datë 29.01.2024, SHTR Radio HIT FM SHPKNJP Shkup i plotëson kushtet minimale kadrovike të përcaktuara në Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio.

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit duhet ta publikojë vendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**